AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

TE EMERTUAR "KUMICOLOR"

Sot me daten 23/02/1994 (netedhjetekater), ne Tirane u redaktua akti i themelimitte shoqerise me pergjegjesi te kufizuar(SHPK) qe i perket ortakeve:

Petrit Kumi, i biri i Xhaferrit dhe i Meremes dt.1.1930, banues ne Tirane ne Rruga "Brigata e 8 te" Nr.3/I dhe Blendi Kume, i biri i Petritit dhe i Deshires dt.1.1969, banues ne Tirane ne te njejten adrese.

Neni I

Akti i themelimit, si dokument kryesor, mbeshtetet ne nenet 37 e vijues te Ligjit Nr.7638 date 19/XI/1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne vullnetin e shprehur nga ortaket, qe krijon te drejta dhe detyrime reciproke per palet kontraktues.

Neni 2

Emertimi/Ne mbeshtetje te nenit 37 te Ligjes Nr.7638 shoqeria private (tregtare) me pergjegjesi te kufizuar(SHPK) emertohet "KUMIKOLOR". Neni 3

Kohezgjatja/Aktiviteti i shoqerise do te kete nje zgjatje kohore me teper se 10(dhjete) vjet, duke filluar nga data e leshimit te licences perkatese nga organi kompetent.

Neni 4

Vendi se ku do te zhvillohet aktiviteti/ ne qytetin e Tiranes (ne disa pika) dhe ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise. Selia e shoqerise do te jete ne Tirane ne Rruga "Brigata e 8 te" Nr.3/I

Neni 5

Kapiatli themeltar i shoqerise do te jete ne shumen 100000(njeqindmij)leke, shume e cila eshte arketuar ne Banken e Kursimeve Tirane me mandat arketimin Nr.3136 date 23/02/1994, pre[illegible] te ciles 50000 leke investohen nga Z.Petrit dhe 50000 leke nga zoti Blendi. Ne raport me investimin midis ortakeve do te behet dhe ndarja e fitimit, pra secili do te marre nga 50% te tije(fiti[illegible]

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete: aktivite[illegible] ne fushen e fotografimit (studio e natyre), zhvillim e stampim te çdo materiali fotografik, filmime te çdo lloi, sherbim audio video

dhe tregtim te artikujve indústrial si materiale e aparate fotografike,(kamera etj.),materiale filmike,kulturore e artist ke te kesaj sfere,botim fotografish,kartolinash,gazete kulturore artistike,~~kalimxfotografikykartolinash~~,e informative per foto,TV,kinematografi etj.

Neni 7

President i shoqerise zgjidhet zoti Petrit Kumi i cili nga ky moment merr atributet e drejtimit te shoqerise. Detyrat dhe te drejtat e tije jane percaktuar detajueshem ne statutin e shoqerise.

Neni 8

Shoqeria ka te drejte te antaresohet ne Dhomen e Tregtise Tirane duke plotesuar detyrimin financiar perkates.

Neni 9

Per nevoja te veta shoqeria ka te drejte te marre ne pune punonjes me meditje me te cilet do te lidhe kontrate pune ne zbatim te ligjes "Per mardhenjet e punes",duke parashi kuar kohen e punes dhe te pushimit,pagesen ditore,mardhenjet me sigurimet shoqerore etj.

Neni Io

Shoqeria do te kete vulen e saje,forma,madhesia dhe emblema percaktohen nga Presidenti i mkortakrise.

Neni XI

Akti i themelimit te shoqerise (SHPK) redaktohet ne tre kopje.Lexohet nga ortaket te cilet pasi shprehen dakort me permbajtjen e tije nenshkruhet rregullisht e pa vrejteje.

O R T A K E T

(Petrit Kumi ) ( Blendi Kumi )

# S T A T U T I

## I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR TE MERTUAR "KUMICOLOR"

### Neni 1

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "KUMICOLOR" krijohetmbi bazen e nisjatives dhe te kapitalit themeltar te ortakeve:

Petrit Kumi i biri i Xhaferrit dhe i Meremes dt.1.1930,banues ne Tirane ne Rruga"Brgata e 8 te" Nr.3/1 dhe Blendi Kumi,i biri i Petritit dhe i Deshires dt.1.1969,banues ne Tirane ne Rruga "Brigata e 8"Nr.3/1

### Neni 2

Shoqeria krijohet dhe zhvillon veprimtarine esaje ne perputhje me normat e ketij statuti si dhe te legjislacionit te Republikes se Shqiperise.Kjo shoqeri si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (SHPK) i perballo humbjet deri ne kufirin e vleres se kapitalit themeltare te saje.

### Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do te jete:aktivitet privat ne fushen e fotografimit (studio e natyre),te zhvillimit e te stampimit te çdo materiali fotografik,filmime te çdo lloi,sherbim audio video dhe tregtim te artikujve industrial,si materiale e aparte fotografike te çdo lloi (kamera etj.),materiale filmike,kulturore e artistike, botime fotosh,kartolinash,gazete kulturore artistike e informative per foto,TV,kinematografi etj.Materilalet e tregtuara do te jene me pakice e shumice,import eksport.

### Neni 4

EMERTIMI,SELIA,Teritori

Kjo shoqeri (SHPK) emertohet "KUMICOLOR" e cila do te fitoi personalitetin e saje juridik nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

### Neni 5

Shoqeria do te kete seline e saje ne Tirane ne Rrugen "Brigata e 8 te" Nr.3/1

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine private ne gjithe territorin e REPUBLIKES se Shqiperise si dhe jashte saj . Ajo mund te krijoje dege ose perfaqesi edhe ne rrethe te tjera te vendit si dhe jashte tij.

KAPITALI THEMELTARE I SHOQERISE

Neni 6

Kapitali themeltare perbehet nga kontributi i te tre ortakeve ne shumen e pergjithshme prej 1000 USD Kapitali themeltare do te depozitohet ne nje banke te qytetit te Tiranes para fillimit te aktivitetit te Shoqerise .

Neni 7

Kapitali themeltare mund te shtohet ose te zvogelohet ne varesi te rezultateve dhe nevojave ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ai mund te transferohet jashte Shoqerise ose te lihet peng ne perputhje me dispozitat e legjislacioit ne fuqi.

Neni 8

Kapitali themeltare eshte lirishte i transferueshem ne rruge trashigimnie , Bashkeshortja, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake ne permjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltare me vendim te Asamblese se ortakeve dhe ne baze te legjislacionit ne fuqi .

FONDET E SHOQERISE

Shoqeria percakton fondet e meposhtme:

1) Fondin themeltare ( qarkullues)

2) Fondet rezerve

3) Fondet e tjera te cilat munde te jene te nevojshme gjate veprimtarise se saj.

Masat e secilit find dhe menyra e perdorimit te tij percaktohen me vendim te organit drejtues te Shoqerise.

ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 10

Si organ i vetem drejtues te Shoqerise esht Asambleja e ortakeve . E gjithe veprimtaria e Shoqerise percaktohet dhe drejtohet nga Presidenti i saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Neni 11

Per administrimin e Sho erise, ose te aktivi teteve te vecanta te saj, Presidenti mund te emeroje nje ose disa administratore.

Neni 12

Kopetencat e administratorve te mundshem ne menyre te pergjithshme percaktohen ne statut dhe detajohen e konkretizohen ne aktin e tyre te emerimit ,

Neni 13

Shoqeria nuk merr persiper veprimet te ndryshme te mundshme te Administratorit ne maredhenje me te tretet , te cilat i tejkalojne kopetencat e tij te percaktuara ne statut dhe ne aktin e emerimit.

Neni 14

Presidenti per te shqyrtuar bilacin vjetor te ardhurat e qarkulluara si dhe menyren e mbajtjes te regjistrimit te veprimeve kontabel emeron nje ose disa eksperte kontabel, per nje periudhe prej te caktuar. Emerimi i eksperteve kontabel eshte i detyrushem per rastet e parashikuara ne ligj.

Neni 15

KOMPETENCAT E PRESIDENTIT

Persa kohe qe Shoqeria do te perbehet nga ortaket Presidenti i saj do te kete disa kompetenca ekskluzive , si me poshte:

Vendos per ndryshimet ne statut dhe miratnn rregulloret e shoqerise ose te sektoreve te vecante te sa

Vendos per politiken afariste te shoqerise dhe percakton fushat konkrete te veprimtarise se saje.

Emeron dhe shkarkon administrateret e shoqerise dhe percaktonkompetencat e plota te tyre.

Shqyrton bilancin vjetor,kuotat e fondeve te ndry shme si dhe fitimin e realizuar.

Vendos per krijimin e degeve ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive ose te ndermarrjeve te perbashketa.

Vendos per marrjen e kredive si dhe per mbarimin e shoqerise,ne se ne dokumentet financiare rezultatete e shoqerise tregojne humbje.

Vendos per shendrrimin e shoqerise nga SHPK ne shoqeri te llojeve te tjera qe parashikohen ne Ligjen Nr.7638 "Per shoqerite tregetare".

Miraton ose realizon mardhenjet me te rendesishme te shoqerise me persona te tjere juridik os e fizik.

Miraten ose realizon cmimet e shitjes ose te sher bimeve te ndryshme.

Vendos per pagat e personelit te punesuar ne shoqeri.

Vec kompetencave te lart permendura,te cilat jane ekskluzive per te,presidenti,ne rastet kur nuk ka emeruar administrator,kryen dhe detyrat qe ne kete statut jane percaktuar per kete te fundit.

## KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

### Neni 16

Kompetencat e plota te administratorit percaktohen ne aktin e emerimit.Vec te tjerave qe mund te percaktohen ne kete akt administratori ka dhe keto kompetenca:

Kujdeset per funksionimin e perditeshem dhe normal te aktivitetit ekonomik dhe financar te shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit te sa je.

Pergatit dokumentacionin dhe relacionin per gjendjen ekonomike dhe financiare te shoqerise , sipas legjislacionit ne fuqi dhe ja paraqet per shqyrtim presidentit.

Kordinon veprimtarine e personelit te punesuar ne Shoqeri.

Shqyrton oferten dhe pergatit kontraten te cilat ja paraqet presidentit per miratim.

Ndjek problemet e Shoqerise ne maredhenje me organe te ndryshme shteterere ose oakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.

I propozon Presidentit cmimet e Shitjes e te sherbimeve si dhe pagat per personelin e punesuar ne shoqeri.

I propozon Presidentit rregulloret per sektore te vecante te veprimtarise se Shoqerise.

## NDARJA E FITIMIT

### Neni 17

Pas perballimit te detyrimeve, taksave, tatimeve shpenzimeve te ndryshme, pagave te punonjesve etj, ortakeve i mbeten ne dispozicion fitimi neto.

### Neni 18

Fitimi neto mund te perdoret per zgjerimin e kapitalit themeltare, per shtimin e tije me kapital ne natyre, per shtimin e fondeve te Shoqerise etj.

Fitimi neto mund te perdoret dhe per qellime te tjera.

## KOHE ZGJATJA E SHOQERISE

### Neni 19

Kjo Shoqeri krijohet per nje afat 15 vjecar.

### Menyra e perfaqesimit

Shoqeria perfaqesohet nga Presidenti i saj ne te gjitha marredhenjet e ndryshme juridike. ajo mund te perfaqesohet edhe nga ndonje person tjeter.

i paisur me prokure te posacme ose autorizim te veoante.

MARDHENJET E PUNESIMIT

Neni 2o

Cdo person i punesuar ne shoqeri,duke perfshire dhe administratorin e mundeshem,konsiderohet si i tille mbi bazen e kontrates te punes,te lidhur nder mjet tije dhe presidentit te shoqerise ne perputhje me legjislacionin e punes ne fuqi.

PERGJEGJESIA E PUNONJESEVE DHE KONFIDENCIALITE

Neni 21

Cdo person i caktuar si administrator ose i punesuar ne shoqeri eshte personalisht pergjegje gjes per kryerjen e detyres.Ai eshte i detyruar te ruaj karakterin e fshehte te dokumentacionit,te informacionit,te pervojes se fituar si dhe te cdo materiali tjeter te konfidencial.Ai eshte gjithashtu i detyruar te permbushe te gjitha detyrimet qe rrje dhin nga kontrata e punes,si dhe nga vendimet e presidentit.

MBARIMI I SHOQERISE

Neni 22

Veprimtaria e shoqerise mbaron me vendim te organit te saje drejtues,ne rast se aktiviteti i saje nuk rezulton fitim prures,per shak te forces madhore dhe te shkaqeve te tjera ligjore.

Neni 23

Shoqeria mund te mbaroi edhe me ane te rior ganizimit nepermjet formave te thithjes dhe te bashkimit.

Neni 24

Gjate fazes se likujdimit te shoqerise Presidenti,administratori dhe eksperti kontabel kane te njejten pergjegjesi.

Neni 7

Viti financiar i shoqerise fillon me 2 Janar te cdo viti dhe perfundon me 31 dhjetor te vitit ne vazhdim.

Pasuria e shoqerise mund të sigurohet ne Institutin e Sigurimeve Tirane,duke qene e detyruar te plotesoi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga antrsimi.

Shoqeria do te kete vulem s saje,forma dhe madhesia e se ciles persaktohet nga drejtuesit e ortakrise.

Ortaket pasi njihen me permbajtjen e statutit dhe shprehen dakort me te e nenshkruajne pa vrejtje e me vullnet te lire.

O R T A K E T

( Petrit Kumi ) ( Blendi Kumi )